



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

Nr. Prot. _____

Tiranë ___/___/2022

VENDIM QARKULLUES

Nr. 36, datë 30.11.2022

PËR
PËRJASHTIMIN NGA SKEMA DHE REVOKIMIN E CERTIFIKATËS SË
SIGURIMIT TË DEPOZITAVE TË BANKËS ALPHA ALBANIA SH.A.,
TË PËRTHITHUR NGA BANKA OTP ALBANIA SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 28, pika 1, të nenit 30, pika 1, shkronja “a”, të nenit 31, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” të ndryshuar, të nenit 8, pika 3 dhe nenit 9, pika 4 të Udhëzimit nr. 3241, datë 18.12.2014 “Për sigurimin e depozitave në banka” të ndryshuar, të nenit 18, pika 2 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 24, pika 1 shkronja “k” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, të nenit 220, pika 3 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, si dhe të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 49, datë 23.11.2022 “Për dhënien e miratimit paraprak për bashkimin me përthithje të Banka OTP Albania SH.A me Bankën Alpha Albania SH.A.”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të përjashtojë nga skema e sigurimit të depozitave Bankën Alpha Albania SH.A. të përthithur nga bashkimi me Bankën OTP Albania SH.A.
2. Të revokojë certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Alpha Albania SH.A. Ngarkohet Banka OTP Albania SH.A., që të dorëzojë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave të Bankës Alpha Albania SH.A menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.





3. Ngarkohet Banka OTP Albania SH.A. që të mbajë të veçuar depozitat e siguruar të subjekteve pjesëmarrëse në këtë proces, për një periudhë tre-mujore nga hyrja në fuqi e revokimit të licencës të Bankës Alpha Albania SH.A., që përkon me çregjistrimin e kësaj të fundit si shoqëri e përthithur në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
4. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare, shpallet në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë, si dhe në një gazetë kombëtare.
5. Ngarkohen Sektori i Sigurimit dhe Kompensimit të Depozitave, Sektori i Marrëdhënieve me Publikun, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës lidhur me këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me çregjistrimin nga Qendra Kombëtare e Biznesit të Bankës Alpha Albania SH.A. si shoqëri e përthithur.

Shqipe Malaj

Sekretare

Donald Duraj

Kryetar

